



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti i mbledhjes së 24 të Qeverisë së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/25

Datë: 03.07.2008


Në mbështetje të nenit 92. 4, nenit 93.11 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Vendimet ekzekutive të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Nr. 2007/60, Nr. 2007/61, Nr. 2007/62, nr. 2007/63 dhe Nr. 2007/64, të gjitha të datës 18 dhjetor 2007, vazhdojnë të mbeten në fuqi, përkatësisht anëtarët e kuvendeve komunale dhe kryetarët e komunave të cekura në vendimet e lartshënuara vazhdojnë funksionimin e tyre deri në inaugurimin e kuvendeve të reja komunale dhe zgjedhjen e kryetarëve të rinj të këtyre komunave në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Duke marrë parasysh që sipas nenit 6.2 të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjedhjes së Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 dhe dispozitat e Kushtetutës, respektivisht nenit 123 pika 4 "*Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre*" si dhe nenit 5.2 të Ligjit mbi Zgjedhjet Lokale, Qeveria e Republikës së Kosovës, konfirmon se vendimet ekzekutive të PSSP-së Nr. 2007/60, Nr. 2007/61, Nr. 2007/62, nr. 2007/63 dhe Nr. 2007/64, të gjitha të datës 18 dhjetor 2007, vazhdojnë të mbeten në fuqi, përkatësisht anëtarët e kuvendeve komunale dhe kryetarët e komunave të cekura në vendimet e lartshënuara vazhdojnë funksionimin e tyre deri në inaugurimin e kuvendeve të reja komunale dhe zgjedhjen e kryetarëve të rinj të këtyre komunave në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

  
**Hashim THAÇI**  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- ICO
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92. 4, nenit 93.11 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Vendimi ekzekutiv i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Nr. 2003/13, i datës 30 gusht 2003, duke përfshirë edhe pjesët tjera të amandamentuara, duhet të vazhdoj të zbatohet deri në shfuqizimin, zëvendësimin ose amandamentimin e këtij vendimi në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Duke pasur parasysh nenin 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh që *“legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amandamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë”*, Qeveria e Republikës së Kosovës, konfirmon se vendimi ekzekutiv i PSSP-së Nr.2003/13, i datës 30 gusht 2003, duhet të vazhdoj të zbatohet deri në shfuqizimin, zëvendësimin ose amandamentimin e këtij vendimi në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- ICO
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit propozon këta anëtar:
  - Dino Asanaj
  - Fadil Ferataj
  - Haxhi Arifi, BSPK
  - Slllobodan Petroviq
  - Bahri Shabani
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që propozimet nga pika 1. e këtij vendimi, së bashku me CV-të e kandidatëve, t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Vendimi i dërgohet:  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/25

Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ngrirje të çmimit për korrje-shirje të grurit dhe elbit, si dhe auto kombajnerët të furnizohen me derivate të naftës me çmim më të ulët për 30%.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani Financiar i shpenzimeve lidhur me demarkacionin e kufirit shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, i ofruar nga Komisioni qeveritar për përcaktimin e vijës së demarkacionit mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë i themeluar me vendim të Qeverisë nr. 06/13 të datës 27 mars 2008.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Kryeministrit për plotësim-ndryshmin e tabelave të shpenzimeve.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për bartjen e shumës së përcaktuar për Komisionin qeveritar për demarkacion, nga fondi rezervë i Ministrit të Ekonomisë dhe Financave në Zyrën për Buxhet dhe Financa në Zyrën e Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi pas plotësim-ndryshimit të tabelave të shpenzimeve të bërë nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Hashim THAGI

Kryeministër i Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/25

Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave për rialokimin e katër projekteve kapitale në një projekt të vetëm kapital.
2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 08/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ për Asgjësimin e Mbeturinave të Produkteve Medicinale.
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme që nga Strategjia Legjislative e vitit 2008 e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të hiqet Projektligji për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë Gjyqësore.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:  
- të gjitha ministrave (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet plani i Ministrisë së Punëve të Brendshme për shtimin e orarit ditor të punës në 11 orë, dhe aplikimi i orarit 8 orësh të shtunave, në Departamentin e Prodhimit të Dokumenteve (DPD) dhe në Qendrat Komunale të Regjistrimit Civil (QKRS), me qëllim të realizimit të programit për dokumentet e reja të Republikës së Kosovës.
2. Katërqindëgjatë (406) punëtorët e përfshirë në këtë projekt, të cilët punojnë me orar të shtuar, do të realizojnë të ardhura mujore shtesë në vlerë prej 200 Euro në muaj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/25

Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet dhe Direktiva për politikën lidhur me Partneritetet Publike-Private.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin dhe Direktivën e përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THACI  
  
Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin e përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 13/25  
Datë: 03.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Shfrytëzimin, Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Ndërtesës në Bashkëpronësi.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin e përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:  
- të gjitha ministrave (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës